



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI I BASHKISË

NJOFTIM PËR SHTESA NË RENDIN E DITËS
Mbledhje Jashtë Rradhe
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 50, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E HËNË, DATË 31.08.2020, ORA 12:00, NË MBLEDHJEN JASHTË RRADHE QË DO TË MBAJ KËSHILLI NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, DO TË KEMI SHTESA (SHTOHEN 3 PIKA) NË RENDIN E DITËS SI MË POSHTË:

****	MIRATIMI I SHTESAVE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projekt- vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 4, 5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, ISHËM, BASHKISË DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i	PËR MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, VKB NR. 64, DATË 07.07.2020, VKB NR.70, DATË 20.07.2020 DHE VKB NR. 81, DATË 10.08.2020 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR

projekt-vendimit	RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË PESTË ME SUBJEKTET PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e **Komisionit të Këshillit Bashkiak** pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (**RAPORTIN**) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

DATA 31.08.2020 Pika 4 dhe 5 do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- b. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimi Tokës
- a. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike

DATA 31.08.2020 Pika 6 do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- b. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja